



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:153990

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05577736

KPPP.nr.451/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Obiliqit - Drejtoria e Inspektionit, me seli në Obiliq, kundër debitorit Operatori “Kastrioti” SH.P.K., me NUI: 810386624, me seli në Obiliq, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.02/23 të datës 16.01.2023, të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Operatori “Kastrioti” SH.P.K. ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.02/23 i datës 16.01.2023, i Përmbartuesit Privat Afet Mjeku dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Obiliqit - Drejtoria e Inspektionit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.02/23 të datës 16.01.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të titullit ekzekutiv gjobës Nr. 000464 të datës 23.12.2022, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 300.00 €, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e lejimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe me ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitorit në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, si dhe me regjistrimin,

vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se urdhëresa e bashkëngjitur është dorëzuar në fotokopje, është e palexuar dhe nuk mund të kuptohet se e njëjta përbën dokument autentik dhe si i tillë akti administrativ i cekur si në propozim nuk mund të përmbartohet. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit në tërësi si i bazuar, të anulohet urdhri përmbartimor dhe përmbartuesi privat të shpallet jo kompetent nga aspekti lëndor për vendosje sipas propozimit të kreditorit.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitur në prapësim, si dhe shqyrtimit dhe vlerësimin të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbartimi - Urdhëresë për Pagesë për Ndëshkim me Gjobë Mandatore Nr. 000464, i datës 23.12.2022, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbartimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti Urdhëresë për Pagesë për Ndëshkim me Gjobë Mandatore Nr. 000464, i datës 23.12.2022, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk përmban tiparet e një vendimi të organit administrativ, i cili mund të këtë cilësinë e dokumentit përmbartues sipas nenit 23 par. 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse*

akt pajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.”

Gjykata vlerësoi urdhrin për përmbarim duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 4 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.”* dhe gjeti se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim, për shkak se dokumentit mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbarimit i mungon përshtatshmëria për ekzekutim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilës përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore lidhur me këtë çështje, duhet të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.451/24, datë 16.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.